

LIRINDJA #02



# Këpucat e mira qepen për ata që nuk ecin shumë

ose

## Fëmijnia n'VHS

Kaltrina Krasniqi

Familja jeme nuk ka shumë fotografi prej viteve '90. Nji ditë e pyeta nanën për detajet mbi mungesën e ktyne lloj arkivave, ajo pa u lodhë me i hy thellë-sive tha: *Normal që nuk kemi, nuk kemi pasë pare m'i bo...po edhe t'i kishim pasë çka kishim dokumentu? Varfninë?*

Unë nuk e kujtoj kët' dekadë si njeri i varfun. N'fakt në shumë nivele ma e mbushun jam n'i. Ndoshta ka lidhje me faktin që pjesa ma e madhe e kohës asht kalu mbyllun n'shpi. Aty ka qenë MTV'ja (kujtimi i parë: David Bowie- Let's Dance), letërsia botnore (e përkthyme serbisht), kandi i vizatimit (n'dhomën e përbashkët) edhe librat traumatik të matematikës. Gjithçka krejt bashkë, edhe lulet e ballkonit bile, ato dimnit n'shtëpinë tonë konkurroshin për t'njejtën hapsinë me njeriun. Asht dashtë me i ba 25 vjet për me fillu me e pranu natyrën prapë, atëherë nuk e kuptojsha averzionin prej saj. Mandej i mbusha 30 vjet edhe kuptimi u fry si ballon - prej moshës 13 vjeçe na shumë rrallë kemi dalë në natyrë...Natyra n'princip, nuk asht konsideru ambient i sigurt.

Me këtë informatë, prapë, m'iluminoi nana.

Këto kujtime, që nuk jon bash mirë t'palume, filluen me dalë n'periudhën kur nisa me shkru mbi mirëmbajtjen e idesë së kombit përmes filmave dhe

emisioneve t'pavaruna që paketoheshin n'VHS. Këto t'njejtat për nji dekadë rresht u shitën n'miliona kopje n'Kosovë e diasporë tu shërby si edukatori i vetëm n'gjuhën amtare. Periudhë kjo kur shqiptarët e Kosovës nuk kishin as radio e as televizion n'gjuhën e tyne, regjimi të gjithë i kishte përjashtu prej jetës institucionale.

Meqenëse këto materiale nuk i kisha pa gjatë rritjes, tash n'moshë t'pjekun iu kisha hy arkivave t'programit zbavitës. Nuk muj me thanë se zbavitësia shumë, por definitivisht çdo ditë mësojsha diçka. Aty njerëzit edukoheshin sistematikisht për me duru, me shkelë gra, me dashtë nanën burrnore që hesht dhe e respekton babën, me qenë shqiptarë t'Shqiptarisë edhe me urrejtë çdo komunist. Komunisti identifikohesh me shkaun/armikun. Shqiptari komunist ish' zakonisht shërbëtor i shkaut. Përderisa komunistat e Shqipnisë ishin mësuesit e ri t'Kosovës t'pavarun që do të bahej nji ditë. Çdo shqiptar i Kosovës, normalisht, n'mënyrë hiper korrekte dialogojke me tjetrin bashkatdhetar n'toskënisht, gjegjësisht, në gjuhë t'unisueme. Krejt këto tema që seriozisht çalojshin n'profesionalizëm e përmbytje ishin t'përcjelluna me muzikë t'thjeshtë e t'bame n'shpejtësi. N'këtë muzikë bendi ish përjashtu prej punës. E tekstshkruesit i kish' hupë fjalori, punojke me tri-katër shprehje

edhe ndoj idiomë popullore. Nganjherë aty këtu imazhe të qytetit ishin vjedhë e ky zbulim m'bajke kurrështare edhe ma ofrojke durimin e mjaftueshëm me shiku krejt atë jetë n'VHS. Interesant, aty nuk ndodhke luftë, as që mendohej për të; gjithçka xhirohej n'ambijente t'mrendshme t'kafeve ose shtëpive. Aty shqiptarët ishin viktimat e përhershme e serbët në ata filma folshin shqip. Gratë e tyne zakonisht ishin kurva ose tradhtare.

N'atë botë kamera rrallë mbështetet n'tripod, asht brutalisht konkrete dhe e zhveshun prej estetikës elementare dhe kompozicionit. Meqenëse kom studiu film, këto pamje dhe krijuesit e tyne shpesh m'piklojshin, sepse ishin t'bame prej mësusave t'mi që i kisha ndëgju 4 vjet n'akademi.

Sidoqoftë, kjo bredhje n'vitet '90 nuk m'i dha krejt përgjegjet për fëmijninë teme t'harxhume n'dhomë. Përkundrazi, nuk e kuptojsha kur mrriva me u dashunu n'David Bowie-in edhe pse pata vendosë me u ba si ai?

Ngjan që kjo aferë ka fillu me dëshirën mos me u identifiku vetëm si çikë, mandej me faktin që diku thellë e kisha kuptu moti se këpucat e kuqe solemne t'llakut nuk ishin dizajnu për çikat e qytetit tem pa festa e asfaltit t'mjaftueshëm. *Let's Dance* pat mrri n'duert e mija 10 vjet mas prodhimit, e video, pavarësisht kohës së ecun, vazhdojke me qenë i vërtetë për mu. Qe pse:

Aty David Bowie asht njeri i bardhë -n'mes grues e burrit- që me gitare shërben. Këndon ashtu i ngrysun në nji qosh t'kafës së punëtorve. Ndonjherë kët' rol e ndërron e shndërrohet në patron të fëmijve t'Amerikës latine që punojnë n'fabrikën e qytetit

t'andrrave. Ata fëmijë nuk kishin me qenë aty sikur nji ditë t'mos kishin ra këpucët e kuqe t'llakut prej qiellit edhe sikur çikës së zezë, *Hirushes*, t'mos i kishin ba tamam. Këta fëmijët e gjejnë qytetin n'ato këpucë dhe nisen me e realizu. Paraqitja e Bowie't prej *Princi t'Vogël* por n'moshë, shkrihet n'pamje t'personazheve të cilëve u këndon, duke i ftu n'vallëzimin e mbathun me këpucë t'kuqe. Fjalët e tij gërshetohen me kërkimin që fëmijët prej pylli i mbyllë n'fabrikë për orë të tana dhe nuk i lejon me u kthy gati kurrë prej kah kanë ardhë. Çika e fshinë autostradën me furçë tu e andru vallëzimin në këpucë t'kuqe t'llakut dhe mbetet imazhi më impresiv i refrenit.

Nji ditë t'lodhun, fëmijët e zi vendosin me shiju qytetin, bredhja nëpër dyqane u mërzhitet, e marrin udhë për n'pyll. T'gëzuem që erdhën n'shpi, kuptojnë se duhet me i sakrifiku këpucët, i shkelin si magjinë e zezë dhe vendosin me mbetë aty n'mes t'drunjëve.

Asht interesant kuadri mbyllës - sakrifiki-mi i këpucëve ndodhë në maje t'kodrës e cila e sheh qartë qytetin që po i afrohet me hangër.

Tu qenë fëmi i varfun (pa e dijtë), ngjanë që gjithmonë kam pasë vetdije se n'qytetin e madh une kisha me qenë ajo çika që e lanë autostradën me furçë, sepse kështu pat vendosë fund-shkullli, lufta n'horizont dhe dhimbjet e rritjes për t'cilat vonë kuptova që nuk t'lëshojnë kurrë.

Sot, mbas 10 vjet heshtje, David Bowie u kthye me krejt nostalgjinë e kohnave që nuk i jetova, por i njoh. Çuditërisht, ma ka nxe mirë zemrën prej borës së madhe që m'i pat mbyllë kujtimet e asaj që megjithatë ka qenë fëmijni e mirë.



# Sizifi katërmëdhjetë-vjeç dhandërr n'prehnin e mëkatit

Sokol Ferizi

Dy momente i kujtoj nga feminija e që ndoshta një ditë kanë me ma ba ma t'qartë distancën fort t'natyrshme e fort t'dhimbshme prej familjes, prej kontekstit politik, historik e kulturor t'vendlindjes. Dy momente t'thanuna si kalimthi, ama shpesh, prej nanës teme – mue posaçnisht, mujnë me m'shërbye si pika orientimi për çorientimin tem individual, e ndoshta edhe t'gjeneratës teme, e para gjeneratë që u hi n'pubertet n'shekullin 21 n'vendlindje, e para gjeneratë që u rritë, e asht tuj u rritë me ndamjen para lufte/mas lufte n'psiqikë. E para gjeneratë që s'ndjen gja për historinë, as Jugosllavinë, as familjen e shoqinë e organizueme.

Mue nana m'ka thanë shpesh: “Djali jem, kur m'ke lindë ti, jemi kanë n'kushte shumë t'vështira.”

Unë kam lind n'1987-ën, shtatë vjet masi u dek Tito, dy vjet masi u dek Enver Hoxha, e dy vjet para se me ra muri i Berlinit.

Tash mue â ka m'doket që kjo asht arsyeja pse unë si individ nuk kam trashëgue nga rritja me prindë kurrfarë predispozite për me dëshiru mirëqenie, s'kam kurrfarë imagjinate për Jugosllavinë, për shembull, që kish me m'përgaditë me gjetë rrugën prej varfnisë për n'borgjezi e tutje dej te naj status shoqnor.

Unë nuk i përjetoj klasat si nevojë, e aq ma pak ndjej dëshirë me i taku naj botëkuptimi, qoftë politik e historik a kulturor e klasor. Prandaj as s'kam, as nuk kam me pasë ambicie për me iu përvesh punës për me u kacavjerr n'hierarkinë shoqnore. E as me e interpretue jetën si hierarki. Edhe pse betejet e mia si individ janë gjithmonë t'lidhuna me një lloj hierarkie njerëzore. Për t'cilat s'ndjej gja tjetër

pos pikëllim.

Asht evidente n'refektimet që i baj me veten se kjo mungesë e natyrshme për me takue dikund, e kjo distancë gjithash-tu e natyrshme prej hierarkive, asht ba arsyeja kryesore pse mbes krejt indiferent edhe ndaj Evropës t'civilizueme, kësaj t'Perëndimit, e cila m'sa mi jep do sheja se zhvillimi njerëzor ka njëfar kuptimi e s'asht çumje kot koha me kontribue n'to, aq m'jep sheja qe duhet me i ikë se s'asht gja tjetër pos trashje me kohë e do vlerave që janë rezultat i interpretimeve hierarkike mbi historinë, politikën e kulturën, e si t'tilla nuk i përgjigjen përvojave t'mia, as motiveve t'mia me met' gjallë.

Tu e ditë që përvoja e prindërve t'mi n'Jugosllavi i ka përgaditë – përmes një peisazhi t'çuditshëm t'përrjetsisë së mirëqenies njerëzore – për me na dhanë neve fëmijve një edukatë që na injekton me natyrshmërinë e t'dëshiruemit përparim, n'kuptimin shoqnor, unë s'kam qysh pretendoj se kam dëshirë me përparue e me “mrrri diçka”, as n'vendlindje as n'civilizimin perëndimor, tue ditë gjithashtu, që unë s'kam lidhje me Jugosllavinë, t'vetmin model mirëqenieje që e njohin prindtë, pos me gërmadhat estetiko-nostalgjike t'saj. Pjesë e këtyne gërmadhave shpesh m'diftohen edhe gjatë kohës që kaloj n'civilizimin perëndimor t'Evropës, që tash s'asht gja tjetër pos vizion mirëqenieje si ai komunist, ama n'faqen tjetër, n'ato pa ideologji.

Fundja, edhe gërmadhat e luftës n'Kosovë, që i kam jetue vetë, s'nxajnë naj vend me peshë n'kuptimin tem t'jetës, pos si kujtime t'zbehta t'fëmijnisë. Si t'tilla m'interesojnë veç për vlerën e

tyne t'padukshme, për potencialin e tyne me zditë gërmadha hala t'pazbulueme njerëzore.

Me një fjalë, unë s'e çaj kryet për kurrfarë procedura civilizueme, as n'nivel shtetëndërtimi as n'nivel emancipimi moral e qytetar; s'e marr vesh asnjë thirrje për 'me u ba njeri', e nuk di me u shty për asnjë gja. Pritoj me zgjedh, prituj me u gzue për ceremoni (që gjithmonë m'janë arsye shtesë me marr izë prej ksaj dynjeje), e as nuk di me u gzue e mu idhnueme me zgjedhjet që, megjithata, m'duhet me i ba n'këtë civilizim. Nuk prituj se jam dembel, se i tillë asht vetë civilizimi perëndimor, pos që nuk kam interesim n'procesin e t'jetuemit n'baza ditore tuj mendue ku përkas, e ku s'përkas.

Unë veç shoh, si i verbti me sy hapë e me shkop midis ruge thue ti që asht tu e trem gjithëçkafin që i del para ruge.

Prapëseprapë, e shoh n'çdo detaj fenomenin e borgjezisë, e sidomos manifestimet trupore e emocionale t'njerëzve që dojnë me i taku kësaj fantazmagorie. Tana hymje-daljet n'shoqni i shosh si një lypës n'qendër qyteti me përvojë varfnije sa vetë jeta. Unë s'di me i taku një shoqniqe t'organizueme, ama di qysh me e përshkru. Nashta pse di me përshkruet asht se ja njoh dizginat, mekanizmat e procedurat e përfshimjes e t'përjashtimit, se jam rrexhë prej tyne pa dashje.

Vetëdija e t'qenit gjallë, për mue, asht ma shumë diçka e çuditshme, për me u kqyrë për seri; me marrë çka t'ka për me u marrë, e mos me çaj kryet për gjana si përgjegjësi e moral, se as gjanat për tu marrë, as aftësia me kqyrë për seri, e as përgjegjësi e moral nuk janë shpikje t'mijat.

Vetëdija jeme lidhet me gjana që veç janë t'kputuna. E pse me u munu me lidhë diçka t'kputun? Sidomos kur nuk e kam pa kurrë t'lidhun?

2.

“Djali jem gjithmonë jam frigue që po ma zhvillon kompleksin e Edipit, se shumë je kanë i lidhun me mue.”

Kjo asht fjali që unë jam msue me e ndi prej nanës teme, muj tham shlrë, prej moshës nand' a dhjetë vjeçare. Nuk di çka e ka ba me besue nanën që unë jam tu e marr vesh. Edhe pse unë gjith e kam ditë për çka e ka fjalën, sikur fmija që e din se sa herë t'i thotë prindi “ma se s'ban ashtu”, fjala ashtu i referohet një veprimi qe i sjellë knaqësi t'veçantë e t'paartikulueshme.

Pa lexue për Edipin, e kam zhvillue kompleksin. Tash m'keshet me e quejtë 'kompleks', edhe me vetën që jam edukue pak, e edhe me nanën që u shpreh n'këtë far gjuhe me mue. Sidoqoftë, këtë kompleks kurrë s'e kam përjetue randë, prandaj kurrë s'e di pse e quejnë kompleks.

Edipi, Edipi, Edipi. E kam pas një shok me emrin Edin, e gjith mu ka kujtue Edipi sa herë e kam menue Edinin cullak. Asht kanë gjeni n'matematikë para lufte, mas lufte kam hangër qebapa n'shitoren e tijë. Gjithmone e kujtoj veten tuj e paramenue Edipin, edhe shpeh kam menue qe asht një vend dikun larg ku dreqi ban vo, a kus-hedi çfarë fantazie tjetër, ama vonë e kam marr vesh qe asht kanë njeri. Ma mirë me thanë mit, ama sa randsi ka a u kanë mit a njeri, kur nana jem gjithë asht tutë? Pos n'ia lejofsha vetës me menue që edhe nana asht mit. S'asht largmendsh!

Nana kurrë s'ma ka spjegue kompleksin, pos me shprehë tutën që fort jam kanë i lidht me to. Që i kam shkue n'banjo me e kqyrë tu u la, e ja kam majt dorën tuj e fshi dhomën me fshisë rryme. Nashta tash e kuptoj pse asht kompleks krejt kjo farë pune: se Edinin kurrë s'e kam pa cullak, e nanën shpesh, ama prej t'parit i maj n'men tana detajet e zhveshuna, e prej t'dytës s'maj n'men bash kurgja.





Çudi asht puna me nanën: gjithmonë insiston n'gjana që fmija i din. E fmija gjithmonë banë gjana që nana tutet. Mbi t'gjitha, lidhja vazhdon me kanë e fortë, e edhe komplekse, ama asnjigja që me u tutë, se nana shpesh ma ka shtrua shtratin, e përmes këtij akti krejt t'zakonshëm e hiç kompleks, m'janë krijue kushtet ma t'volitshme me veprue bash gjana që ajo tutet se i vepro. Jo veç me i ra grusht, po me marr n'gojë sa herë t'i çohet. Jo temin, po, edhe ma zi, t'tjetrit.

Gjithmonë e kam marr n'gojë nër hunë t'sajna. Kur e kam hangër spermën për herë t'parë, taze sa na u pat zi mas lufte – dym'dhjetë â trem'dhjetë vjeç – mu pat dokë që e kam pi një deti. Mas nja pesë minutav' që e kam pi detin, nana që gjithë a tutë se pe zhvilloj kompleksin e Edipit, hini n'dhomë e na tha: "Djema dreka asht gati". Jemi shkue, jemi ulë: vllau i madh, baba, nana e motra ulun n'tavolinë. Kem pas oriz me mish pule (kofshën e kam pas obsesion), e me t'parën kafshatë, si unë si kusherini (gjithashtu i ulun me neve, me prezencën prej dhandri) jemi nal e jemi kqyrë: shija e bukës na'u përzie me shijën e spermës, edhe me heshtjen e buzqeshun t'mëkatit e kem ditë çka asht tuj ba vaki. E kem buzëqesh!

Prej asaj dite skllavnija për mue murr kup-tim tjetër njëherë e përgjithmonë!

Tash me e terezitë këtë përvojë jete me kontekste historike, politike a kulturore e shoqnore asht me randsi, se për ata që e kapërcejnë ylberin asht esenciale me kqyrë çka po bahet me horizontin.

Nashta asht jomodeste me thanë veç horizonti zgjanohet. Edhe slogani i edukimit familjar e institucional që asht "duhet me studju e me zgjanu horizontin," asht gjithmonë i shterrun pa e pi një deti. Se kur ta pinë njeri një deti me spermë i çelet havaja. Ky deklaram që s'muj e baj me u dokë ma serioz a ma pak banal,

asht megjithate i vërtetë sikur gjymtyra që mpihet pa vetëdijen tonë e duhet me e ç'mpi me vetëdije.

Thash se kam lindë në vitin 1987.

Dy vjet para se me ra Muri i Berlinit, e bashkë me to Jugosllavija, e krejt infrastruktura e andrrav' e e shpresav' për "me rrnuë mirë". Bashkë me Murin e Berlinit për një t'ri që e ka hangër spermën mas lufte u ra edhe kufini mendor mes shpisë e gjetit. Jam rritë n'mes, kurr ngushtë s'e kam pas.

*Athu Sizifi e ka pasë kompleksin e Edipit?*

*Athu Sizifi a kanë tu e shtye gurin jo nalta kodre, po n'rrafsh, kah Lindja?*

*Athu Sizifi a kanë çorr e shurdhan e ka menuë që veç n'Perëndim mun shnoshet?*

*E ç'a i ka vyejt shneta Sizifit n'koftë kanë që u mërthy me një mision t'pafund, e që asht kanë fat i tij me dhan shpirt, me shnetë a pa shnetë?*

*Parameno Sizifin tuj pritë n'rën për biletë me hi n'muzeun e civilizimeve t'skatrueme!*

*Parameno Sizifin djalë t'ri tuj dashtë me studju marrdhanie ndërkombëtare!*

*Parameno Sizifin tuj e marr 1-sh n'shkollë, n'Gjermani e n'Kosovë t'njëjtën kohë!*

*Parameno Sizifin tuj hangër mish kofshe e tuj menuë për shokun e vet cullak!*

Lirindja #2  
Zinë e vetbotueme dhe e vetfinancueme

Prishtinë  
Shtator 2013

Kontribues:

Rina Krasniqi, Lura Limani, Nissma Kaj, Noar Sahiti, Kaltrina Krasniqi,  
Sokol Ferizi, Erëmirë Krasniqi, Bujar Sylejmani, Shpëtim Selmani, Salih Hoxha,  
Genc Salihu.

Fotografitë:  
Rina Krasniqi

Dizajni:  
Dritëro Mehmetaj